



**VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHËSHME TË SHOQËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN SH.A.**

Ur. 2584-Prof

NR. 1145 DATE 18/04/2023

Data 18.04.2023

Sot, më datë 18 Prill 2023, Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT L43121201L, mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga administratori i shoqërisë Z. **Çelik Leka**, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

Çështjet e rendit të ditës:

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim;
- Shkarkimi i Administratorit
- Emërimi i Likuidatorit.

Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja vëren:

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr. 4272 Rep. dhe Nr. 2315 Kol, datë 11.10.2022 midis shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha dhe shoqërisë Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivitet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 01.01.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijojë ekzistencën e saj dhe duhet të priset dhe të cregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Asambleja vendosi:

- (1) Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj
- (2) Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
- (3) Shkarkimin e Z. **Çelik Leka** si Administrator të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha
- (4) Emërimin e Z. **Gentian Trasha** si likuidator të shoqërisë.
- (5) Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin e shoqërisë.

Pasi u sigurua se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike si vijon:

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE
KRYETAR

Gledian LLATJA

